



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 16.12.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Blerim Shala, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Fatmir Limaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Xhavit Haliti, nënkryetari i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.11.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2014, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-226, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 18.11.2013;

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integrim Evropian miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.11.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Vjosa Osmani - Nëse flasim për përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, të gjithë e dimë, që në një vend ku funksionon demokracia, projektligji i buxhetit bënë alokimin e mjeteve për institucionet për vitin që vjen dhe nuk është një projektligj përmes të cilit blihet apo shitet diçka. Amendamenti i fundit, i cili ka ardhur në Komisionin për Buxhet, e me anë të të cilit kontrabandohet shitja e PTK-së, përveç që ka ardhur në mënyrë kundërkushtetuese, paraqet edhe kolizion të ligjeve sepse është në kundërshtim me ligjin për ndërmarrjet publike apo me nenin 9 të ligjit për ndërmarrjet publike, me të cilin nen përcaktohet një procedurë krejt tjetër për shitjen e ndërmarrjeve publike. Andaj, duke pas parasysh këto vlerësime dhe për shkak të këtij amendamenti i cili në momentin e fundit është paraqitur në buxhet, unë do të votoj kundër këtij projektligji.

Glauk Konjufca- Pajtohem plotësisht me deputeten Osmani. Ky projektligj, sidomos neni 8 i tij, paraqet një kolizion me praktikën e BE-së. Mendoj se nuk duhet të krijojmë praktika në Kosovë, ku amendamenti i një projektligji do të kalonte dhe do të paraqitej seancës, ku mbase edhe do të miratohej, duke qenë në kundërshtim me korpusin e legjislacionit pozitiv në Kosovë. Nëse e shqyrtojmë këtë amendament se sa është në harmoni me ligjin të cilin e kemi në fuqi për Ndërmarrjet Publike, krijohet përshtypja që kemi të bëjmë me një shtet jo serioz, i cili nuk është fare i gatshëm për tu integruar në BE. Ne nuk mund të themi që ky projektligj është në kundërshtim specifikisht me një ligj të caktuar të BE-së, por me praktikën e BE-së. Kur e kemi parasysh që me ligj kërkohet që Qeveria të sjellë vendim të ndarë për privatizimin e një ndërmarrjeje publike, duhet ta dimë që këtë vendim nuk e ka bërë as në vitin 2011, as në vitin 2013. Nëse duam të japim shembuj të praktikave të mira evropiane, duhet të tregonim se Qeveria po punon në përputhje me ligjin. Kësaj radhe Qeveria nuk ka qenë në përputhje me ligjin andaj edhe kjo është arsyeja pse duhet ta votojmë kundër. Pra, për shkak të amendamentit të të.

Kryesuesi - Njoftoi se për projekt-buxhetin është diskutuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, ku edhe në atë mbledhje tha pati reagime përafërsisht të njëjta nga përfaqësuesit e LDK-së dhe Vetëvendosjes. Ne, tha nuk jemi komision që do të mund të stopojmë procedimin e projekt-buxhetit, sepse Komisioni për Buxhet është Komision funksional dhe i cili do të rekomandojë për seancë miratimin apo mosmiratimin e tij. Për mua, tha është shqetësues fakti që

nuk kam mbërri të dëgjojë asnjë alternativ se si duhet të jetë ky proces i privatizimit nga ata të cilët janë kundër këtij procesi dhe shtoi se i thotë këto jo për t'ia mbushur mendjen dikujt për të votuar pro, por sepse ai konsideron kështu.

Ismet Beqiri- Ne jemi për privatizim, por jemi kundër mënyrës së paligjshme të privatizimit. E them këtë sepse të gjithë e dimë që ligji për ndërmarrjet publike e përcakton shumë qartë mënyrën se si bëhet privatizimi, në këtë rast i kësaj kompanie. Kushtimisht, neve si Grup Parlamentar, nuk po na intereson se kush po e fiton procesin e privatizimit por problemi kryesor është mënyra si është bërë, mungesa e transparencës. Alternativa është kjo vetëm mosshkelja e ligjit dhe rregullores. Ne të gjithë jemi në dijeni se Qeveria e Kosovës ka propozuar një amendament jashtë afatit ligjor, pra pasi kanë kaluar dy javë pune dhe në këtë formë ka shkelur edhe rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës. Andaj, këto janë arsyet pse vota ime do të jetë kundër procedimit të këtij projektligjit me këtë amendament. Ne si grup parlamentar, tha e kemi qëndrimin e formësuar dhe qëllimi ynë është që të korrektojmë Qeverinë. Nuk kemi qenë asnjëherë kundër votimit të buxhetit, por kësaj radhe e kemi bërë publik qëndrimin tonë, që nëse ky projektbuxhet shkon me këtë amendament ne nuk do të hymë fare në seancë. Ndjeshmërinë e kësaj çështje, është Qeveria ajo që duhet ta ketë në konsideratë. Nëse ne do të hyjmë ne votim të këtij buxheti dhe pas miratimit të tij, ai nen që ne e kemi konsideruar kundërligjor do të hyjë në fuqi, atëherë do të dal që ne si grup parlamentar nuk kemi parime.

Ndërsa, sa i përket formimit të komisionit hetimor, pas miratimit të buxhetit, Beqiri tha se do të jetë post festum.

Blerim Shala- Kemi mbërri deri këtu për shkak të një situate të paqartë dhe në momente vendimmarrëse në Kuvendin e Kosovës, për çështjen e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së dhe për formimin e komisionit hetimor parlamentar për privatizimin e PTK-së. Konsideroj se të dy rastet është dashur të procedohen tutje. Tash pas një periudhe të tejkalimit të këtij ngërçi, na kthehen prapë në një formë apo tjetrën në Kuvendin e Kosovës përmes këtij amendamenti. Dalja nga kjo situatë mendoj se ka qenë sjellja me kohë e raportit dhe diskutimi i tij me kohë dhe të formimi i komisionit hetimor për privatizim. Formimi i komisionit hetimor nuk do të kishte penguar këtë proces sepse me anë të tij do të vërtetohej se a ka pasur shkelje të procedurave gjatë tenderimit dhe të shihet se çfarë ka ndodhur. Projektligji tha Shala, duhet të procedohet në Kuvend, me apo pa amendamentin e propozuar që të shqyrtohet. Ne duhet ta dimë që me 20 dhjetor, Fondi Monetar Ndërkombëtar, e ka mbledhjen e Bordit ku vendoset për “state aranzhuan” se a ka qenë në rregull a jo. Pra, janë disa konsekuenca që kanë të bëjnë në raportin e FMN-së me Kosovën.

Suzan Novoberdali- Me anë të nenit 8, po rrezikohet edhe miratimi i projektbuxhetit, gjë që do të ndikojë shumë keq. Si deputete, e kam përkrahur formimin e komisionit hetimor, në mënyrë që të sqarohen gjërat, si për ne deputetët ashtu edhe për opinionin. Pse të mos formojmë komision, të shohim procedurat e në këtë mënyrë do të shuanim edhe pakënaqësitë e qytetarëve, të cilat pakënaqësi rreth privatizimit të postës po rriten dita-ditës edhe më shumë.

Vjosa Osmani - Kemi marrë nga Kryesia e Kuvendit raport para se të futej ky nen në buxhet, ku me atë raport është vlerësuar procesi i privatizimit të PTK-së dhe në mënyrë më specifike në qoftë se Kuvendi i Kosovës ka marrë vendim për ta shitur PTK-në a jo. Në atë raport, shumë qartë thuhet që përkundër faktit që ligji i vitit 2011 e ka pasur një nen të ngjashëm, e në mos edhe

identik me këtë, ai nën është konsideruar si jo i rregullt dhe si i tillë nuk ka mundur të shes PTK-në. Secili deputet e ka pranuar këtë dokument nga Kryesia e Kuvendit. Andaj, mendoj që tani kjo duhet të merret parasysh, ku po tentohet të bëhet e njëjta me amendamentin tetë, me atë që u pati bërë në vitin 2011, e që nga Kryesia u pati vlerësuar si kundërligjor.

Kryesuesi- Kemi dy ministri të cilat është dashur të ishin më të zëshme dhe më bindëse dhe të cilat kanë mundur të na njoftojnë më shumë dhe më gjerësisht rreth këtij procesi, atë të Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë për Buxhet. Unë, tha nuk kamë ndonjë informatë më shumë përveç asaj që kemi si deputetë. Ne kemi obligimin tonë dhe kërkesën që ta qesim në diskutim projektbuxhetin dhe mundësisht ta kalojmë. Unë, tha e qes në votim miratimin e projektbuxhetit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian, me katër vota për, tri kundër dhe dy abstenime, nxori këtë:

Përfundim

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi e ftoi deputeten Suzan Novobërdali, referuese të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novobërdali - Projektligji nr. 04/L-226, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, ka për qëllim ndryshimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë. Projektligji përmban gjithsej 29 nene dhe 24 amendamente nga Komisioni Funksional. Andaj, pas shqyrtimit, konstatoam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-226, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, e ftoi deputetin Albert Kinolli, referues të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli -Projektligji nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka për qëllim krijimin e procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje në Republikën e Kosovës. Kjo fushë nuk është e rregulluar me legjislacion të BE-së, mirëpo, kjo kompetencë i është lënë vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, që me legjislacionin e tyre të brendshme ta rregullojnë në mënyrë më specifike në bazë të politikave të tyre të brendshme.

Andaj, pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni për Integritet Evropian, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Nënkryetari i Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Xhavit HALITI